

5.6 VENDOSJA E FILTRIT TË KËRKIMIT PËR MATERIALET E ÇREGJISTRUARA

Nëse dëshironi mund të vendosni filtrin, me anë të të cilit në dritaren për kërkim të klasës **Fusha 996/997** vendoset si e paracaktuar pyetja për kërkim, e cila nga kërkimi përjashton fushat 996/997 me statusin 9 – *çregjistruar*.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Parametrat / Vendos filtrin e kërkimit për materialet e çregjistruara**.

Hapet dritarja **Filtri i kërkimit**, në të cilën rregulloni filtrin e kërkimit për materialet e çregjistruara, duke klikuar kutinë e zgjedhjes "Filtri për materialet e çregjistruara " (filtri i paracaktuar i kërkimit nuk është i përfshirë).

2. Klikoni butonin **Në rregull**.

Nëse vendosni filtrin e kërkimit për materialet e çregjistruara, pas hapjes së dritares për kërkim **Dritarja për kërkim – Fusha 996/997** tek fusha për kërkim "Statusi (q)" përcaktohet operatori NOT dhe vlera 9 – *çregjistruar*. Para se të filloni kërkimin, pyetjen për kërkim mund ta plotësoni. Nëse pas kërkimit klikoni butonin **Kërkimi i ri** fshihen pyetjet e shënuara për kërkim dhe rezultatet e kërkimit. Gjithashtu fshihet edhe pyetja për kërkim tek fusha "Statusi", ndërsa filtri i kërkimit për materialet e çregjistruara mbetet i përfshirë (dhe respektohet gjatë kërkimit tjetër në klasën **Fusha 996/997**).